



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1072/15 Prot.

Tiranë, më 22.05.2026

VENDIM

Nr. 80, datë 22.05.2026

**“PËR  
MIRATIMIN DHE PARAQITJEN PËR ÇDO VIT AKADEMIK TË STRESS TEST  
(PROVË USHTRIMORE) PËR PËRBALLIMIN FIZIKISHT TË PROGRAMEVE TË  
STUDIMIT BACHELOR NË “SHKENCA TË LËVIZJES” DHE NË “FUSHAT E  
VEPRIMTARISË FIZIKE, TË SHËNDETIT DHE REKREACIONIT”**

Mbështetur në nenin 3, 38, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.57, datë 29.01.2020 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenin 7 dhe 20 të Statutit të UST, Vendimin nr. 81, datë 19.05.2026 të Rektoratit, Senati në mbledhjen e datës 22.05.2026

VENDOSI:

1. Fituesit e konkurseve të pranimit në programet e ciklit të parë Bachelor në “Shkenca të Lëvizjes” dhe “Fushat e Veprimtarisë Fizike, të Shëndetit dhe Rekreacionit”, të paraqesin në fazën e regjistrimit dokumentin e kryerjes jashtë Universitetit të Sporteve të Tiranës të kontrollit “*Stress Test*” (Provë Ushtrimore), për të vijuar studimet në këto programe.
2. Ky Vendim është i vlefshëm për çdo vit akademik dhe i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

